



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

RREGULLORE

Nr. 79 Datë 16 .04.2010

PËR

ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT TË PROKURORISË

Me synimin, riorganizimin dhe funksionimin e Këshillit të Prokurorisë, në përputhje me ndryshimet e ligjit të Prokurorisë;

Pasi, u mor mendimi i këtij këshilli

Në mbështetje, të nenit 12 të Ligjit nr 8737, datë 12.2.2001 “ Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, caktoj këto rregulla:

Neni 1

Përkufizimi

Këshilli i Prokurorisë është organ kolegjal dhe kryen funksione këshillimore në ndihmë të Prokurorit të Përgjithshëm. Këshilli, në ushtrimin e funksionit këshillimor, jep mendime vetëm gjatë mbledhjeve të tij.

Neni 2

Kompetencat

Këshilli i Prokurorisë këshillon Prokurorin e Përgjithshëm pasi :

1. Shqyrton dhe vlerëson, kërkesat e kandidatëve për prokuror, kandidaturat për drejtues të prokurorive të rretheve gjyqësore dhe prokurorive të apelit, kërkesat e prokurorëve për transferim (lëvizje paralele ose ndryshime të ngjashme).
2. Shqyrton vlerësimin e punës së prokurorëve dhe i paraqet, për miratim, Prokurorit të Përgjithshëm raportin e vlerësimit përfundimtar të aftësive profesionale të prokurorëve.
3. Shqyrton shkeljet disiplinore të kryera nga prokurorët dhe i paraqet mendim Prokurorit të Përgjithshëm për llojin e masës disiplinore për prokurorin nën procedim.
4. Shqyrton dhe jep mendim për kërkesat e Prokurorit të Përgjithshëm në lidhje me planin vjetor të inspektimeve dhe tematikën e tyre.
5. Shqyrton dhe jep mendim për vlerësimet e paraqitura në kontrollet e Ministrisë së Drejtësisë, në organet e prokurorisë.
6. Shqyrton dhe jep mendim për projekt-aktet normative të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe propozon masa për organizimin e brendshëm dhe miradministrimin e prokurorisë apo përmirësimin e legjislacionit në fushën penale.
7. Shqyrton dhe jep mendim për unifikimin e politikës së ndjekies penale, në hetim dhe gjykim.
8. Kryen çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj.

Neni 3

Organizimi i konkurseve.

1. Këshilli i Prokurorisë në mbledhje të veçantë shqyrton dhe vlerëson kërkesat e kandidatëve për tu emëruar prokurorë, drejtues dhe kërkesat për transferim.
2. Anëtarëve të Këshillit i vihet në dispozicion lista e kandidatëve për çdo vend vakant të shpallur. Në listën e kandidatëve duhet të pasqyrohen kritere të përgjithshme;

- a) gjeneralitetet e kandidatit,
 - b) rezultatet e përfundimit të studimeve universitare dhe/ose pasuniversitare,
 - c) treguesit dhe eksperiencat në punë,
 - ç) trajnime ose specializime të ndryshme,
 - d) të dhëna në fushën e publikimeve,
 - e) të dhëna për masa disiplinore,
 - f) të dhëna për aftësitë profesionale dhe etiko-morale.
3. Për kandidatët prokurorë që konkurojnë për ngritje në detyrë duhet të paraqiten dhe vlerësimet e punës në dy herët e fundit.
 4. Për kandidatët që konkurojnë për prokurorë dhe kryejnë detyrën e oficerit të policisë gjyqësorë, krahas dokumenteve të përmendura në pikën 2 më sipër, duhet të paraqitet edhe mendimi për vlerësimin e punës nga drejtuesi i prokurorisë ku ushtron funksionet.
 5. Përzgjedhja e kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore bëhet mbi bazën e vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, të përfshira në pikën 2 të kësaj dispozite, si dhe çdo të dhënë që tregon epërsinë e kandidatit përkatës ndaj kandidatëve të tjerë.

Neni 4

Vlerësimi i punës së prokurorëve

1. Vlerësimi i punës së prokurorëve, bëhet nga drejtuesi i prokurorisë, mbi bazën e aftësive profesionale dhe personale, aftësitë dhe qëndrimin shoqëror, aftësisë administruese, respektimin e disiplinës në punë dhe masat disiplinore.
2. Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore për qëllime të vlerësimit të punës së prokurorëve kryen inspektime jo me pak se një herë në tre vjet, duke u mbështetur në treguesit e parashikuara në ligj.
3. Këshilli i Prokurorisë shqyrton vlerësimin paraprak të punës dhe ia paraqet mendimin e vetë Prokurorit të Përgjithshëm.

Neni 5

Shqyrtimi i ankesave për vlerësimin e punës së prokurorëve

1. Këshilli i Prokurorisë shqyrton ankesat e paraqitura për vlerësimin paraprak të punës së prokurorit. Në mendimin përfundimtar të Këshillit mund të refuzohet kërkesa ose mund të fillojë rishikimin i vlerësimit që ka qënë objekt i ankesës.

2. Në rastet e refuzimit të ankesës Këshilli i vë në dispozicion ankuesit mendimin e arsyetuar të marrë në lidhje me ankesën.

Neni 6

Proçedimi disiplinor

1. Proçedimi disiplinor për marrje mase disiplinore ndaj një prokurori, fillon me urdhër të motivuar të Prokurorit të Përgjithshëm.
2. Urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm për fillimin e proçedimit disiplinor i bashkëngjiten:
 - a. Akti i konstatimit të shkeljeve, mbi të cilat është motivuar fillimi i proçedimit disiplinor ndaj prokurorit.
 - b. Raporti i Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore për fillimin e proçedimit disiplinor, që përmban të dhënat përkatëse të cilat provojnë shkeljen e kryer nga prokurori i proçeduar.
 - c. Deklarata e prokurorit se është njohur me aktin e konstatimit të shkeljes/ve dhe se i është kërkuar të paraqesë me shkrim pretendimet e tij lidhur me proçedimin.
 - d. Pretendimet me shkrim të prokurorit që proçedohet, në qoftë se, ka paraqitur të tilla.

Neni 7

Regjistrimi i akteve të procedimit disiplinor

1. Urdhëri i Prokurorit të Përgjithshëm për fillimin e proçedimit disiplinor së bashku me materialet e cituara në pikën 2, të nenit 6 të rregullores, regjistrohen në regjistrin e proçedimeve disiplinore pranë Drejtorisë së Inspektimit dhe të Burimeve Njerëzore dhe nga një kopje e të gjitha akteve u dërgohet të gjithë anëtarëve të Këshillit të Prokurorisë.
2. Për çdo proçedim disiplinor formohet një fashikull i veçantë në të cilin përfshihen të gjitha materialet e proçedimit, deri në mbylljen e proçedurës.

Neni 8

Mbledhja e për shqyrtimin e proçedimit disiplinor

1. Mbledhja e Këshillit të Prokurorisë në të cilën do të shqyrtohet proçedimi disiplinor ndaj prokurorit, caktohet nga Prokurori i Përgjithshëm.
2. Prokurori ndaj të cilit ka filluar procedimi disiplinor duhet të njoftohet për datën, orën dhe vendin e mbledhjes, të paktën 72 (shtatëdhjetë) orë përpara fillimit të saj.
3. Njoftimi realizohet me format e parashikuara nga Kodi i Proçedurave Administrative.
4. Prokurori, në ngarkim të të cilit ka filluar proçedimi disiplinor, ka të drejtë të mbrohet vetë dhe/ose me avokat para Këshillit të Prokurorisë.
5. Avokati ka të drejtë të njihet më të gjithë materialin e proçedimit disiplinor në ngarkim të prokurorit që mbron.

Neni 9

Palët pjesmarrëse në mbledhje

1. Mbledhja e Këshillit të Prokurorisë, për proçedim disiplinor ndaj një prokurori, bëhet me pjesmarrjen e :
 - Anëtarëve të Këshillit të Prokurorisë, ku për zhvillimin e mbledhjes kërkohet pjesmarrja e detyrueshme e së paku pesë nga shtatë anëtarët e Këshillit të Prokurorisë.
 - Prokurori i proçeduar dhe/ose mbrojtësi i tij,
 - Përfaqësuesi i autorizuar i Prokurorit të Përgjithshëm,
 - Sekretari i ngarkuar për dokumentimin e seancës së proçedimit disiplinor.

2. Përpara se të fillojë shqyrtimi i proçedimit disiplinor, bëhet verifikimi mbi paraqitjen e palëve në seancën e zhvillimit të proçedimit disiplinor.
3. Nëse prokurori ndaj të cilit ka filluar proçedimi disiplinor nuk është paraqitur, Këshilli i Prokurorisë shqyrton shkaqet e mosparaqitjes së tij.
4. Nëse mosparaqitja e prokurorit është bërë pa shkaqe të arsyeshme, Këshilli i Prokurorisë shqyrton proçedimin disiplinor.
5. Nëse mosparaqitja e prokurorit është bërë për shkaqe të arsyeshme, Këshilli i Prokurorisë shtyn proçedimin disiplinor për në mbledhjen më të afërt, pasi të jetë shuar shkak i mosparaqitjes.

Neni 10

Seancat e proçedimit disiplinor

1. Me paraqitjen e palëve pjesmarrëse, përpara fillimit të shqyrtimit të proçedimit disiplinor, Këshilli i Prokurorisë shqyrton kërkesat paraprake të paraqitura me parë nga përfaqësuesi i autorizuar i Prokurorit të Përgjithshëm ose të prokurorit të proçeduar.
2. Shqyrtimi i proçedimit disiplinor fillon me relatimin e materialit nga përfaqësuesi i autorizuar i Prokurorit të Përgjithshëm, për shkaqet e proçedimit dhe argumentohen shkeljet e kryera nga prokurori nën proçedim disiplinor.
3. Pastaj, dëgjohej prokurori i proçeduar me masë disiplinore dhe /ose avokati i tij, i cili paraqet mbrojtjen e tij përpara Këshillit të Prokurorisë.
4. Çdo anëtar i Këshillit të Prokurorisë mund t'i bëjë pyetje prokurorit që proçedohet me masë disiplinore për të sqaruar çështje të ndryshme, të cilat kanë nevojë të qartësohen.
5. Këshilli i Prokurorisë është i detyruar të dëgjojë prokurorin e proçeduar me masë disiplinore dhe të verifikoj pretendimet e ngritura nga ana e tij. Në raste të veçanta kur është e nevojshme, Këshilli i Prokurorisë, shtyn seancën për një periudhë jo më shumë se 15-ditore, për verifikimin e pretendimeve të prokurorit të proçeduar.

6. Këshilli i Prokurorisë dhe palët në procesin disiplinor kanë të drejtën e marrjes së provave ose pyetjen e personave që kanë dijeni në lidhje me rrethanat që shqyrtohen.
7. Në përfundim të shqyrtimit të procedimit disiplinor Këshilli i Prokurorisë i paraqet Prokurorit të Përgjithshëm mendimin e tij të arsyetuar, në lidhje me shkeljet e prezantuara dhe masën disiplinore që propozon me shumicë votash.
8. Mendimi i Këshillit të Prokurorisë i paraqitet Prokurorit të Përgjithshëm jo më vonë se pese ditë nga përfundimi i shqyrtimit të procedimit disiplinor.

Neni 11

Rregullat e funksionimit të Këshillit

1. Anëtarët e Këshillit në mbledhjen e parë zgjedhin me shumicë votash kryetarin e Këshillit të Prokurorisë. Kjo mbledhje thirret nga Prokurori i Përgjithshëm menjëherë pas zgjedhjes së anëtarëve të rinj në mbledhjen e përgjithshme të prokurorëve.
2. Kryetari i Këshillit zgjidhet për një periudhë një vjeçare dhe nuk ka të drejtën e rizgjedhjes.
3. Kryetari drejton mbledhjen e Këshillit, siguron zbatimin e ligjit dhe të kësaj rregullore si dhe përfaqëson Këshillin para Prokurorit të Përgjithshëm.
4. Prokurori i Përgjithshëm në rastet kur merr pjesë në mbledhjet e Këshillit, drejton mbledhjen, në përputhje me rregulloren.
5. Prokurori i Përgjithshëm nuk duhet të marrë pjesë në seancat e Këshillit të Prokurorisë kur shqyrtohen procedimet disiplinore.

Neni 12

Mbledhja dhe thirrja e tyre.

1. Këshilli i Prokurorisë, si rregull, mbledhjet e rradhës i zhvillon një herë në dy muaj. Për çështje të ngutshme si dhe për shqyrtimin e procedimeve disiplinore Prokurori i Përgjithshëm mund të kërkojë të thirret mbledhje edhe jashtë rradhe.

2. Prokurori i Përgjithshëm, cakton datën dhe orën e mbledhjes, duke përcaktuar edhe çështjet për të cilat do të thirret mbledhja.
3. Lajmërimi për mbledhjen e radhës të këshillit bëhet jo më vonë se 3 ditë para datës së mbledhjes, ndërsa për mbledhjet jashtë rradhe jo më vonë se një ditë para datës së mbledhjes.
4. Lajmërimi për thirrjen e mbledhjes duhet të tregojë çështjet për të cilat do të diskutohet dhe shoqërohet me materialet që do të shqyrtohen në mbledhje kur ka të tilla.

Neni 13

Rendi i ditës.

Më kërkesë të Prokurorit të Përgjithshëm, Kryetari vendos për rendin e ditës për çdo mbledhje. Rendi i ditës përmban çështjet që Prokurori i Përgjithshëm ka kërkuar për të tërhequr mendimin e Këshillit të Prokurorisë.

Neni 14

Marrja e mendimit

1. Këshilli i Prokurorisë jep mendim vetëm për çështjet që janë përfshirë në rendin e ditës.
2. Mbledhja e këshillit është e vlefshme kur janë të pranishëm jo më pak se pesë anëtar të këshillit të Prokurorisë. Kur nuk plotësohet ky numër anëtarësh të pranishëm, kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër.
3. Mendimet e Këshillit të Prokurorisë paraqiten në formë të shkruar, të arsyetuara dhe nënshkruhen nga kryetari, brenda 5 ditë nga përfundimi i mbledhjes.

Neni 15

Votimi

1. Mendimet e Këshillit merren me votim të hapur.
2. Anëtarët e Këshillit që janë të pranishëm nuk mund të abstenojnë.

3. Sejcili prej anëtarëve të këshillit jep një mendim të arsyetuar në lidhje me procedimin disiplinor dhe masën disiplinore për prokurorin që procedohet me masë disiplinore.
4. Mendimet e njëjta që përbëjnë shumicën inkorporohen në një akt të shkruar të vetëm dhe paraqitet si mendim i Këshillit të Prokurorisë.
5. Këtij mendimi të shumicës i bashkëngjiten edhe mendimet e arsyetuara të pakicës.
6. Në rast barazimi të votave, arsyetohen mendimet e dy palëve.

Neni 16

Konflikti i interesit

1. Anëtari i Këshilli të Prokurorisë nuk duhet të jetë i pranishëm në ato mbledhje, kur shqyrtohet kërkesa e paraqitur për ngritjen në detyrë ose për transferimin e tij.
2. Gjithashtu, ai nuk merr pjesë në mbledhje si anëtar i Këshillit të Prokurorisë dhe në rastet kur do të shqyrtohet masa disiplinore ndaj tij.

Neni 17

Proçesverbali i mbledhjes

1. Në çdo mbledhje mbahet një proçesverbal, ku shënohet data, vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, diskutimet e përmbledhura, mendimet e votuara dhe rezultati i këtyre votimeve.
2. Në rastet kur janë mundësit teknike, diskutimet në mbledhjen e këshillit regjistrohen audio dhe më pas transkriptohen.
3. Proçesverbali i mbledhjes mbahet nga një sekretar teknik, i cili kryen dhe transkriptimin në rast regjistrimi, si dhe pasi verifikohet dhe miratohet, nëshkruhet nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Neni 18

Shpërblimi dhe fondet

1. Anëtarët e Këshillit të Prokurorisë shpërblehen për çdo mbledhje në shumën 5000 (pesëmije) lekë. Gjithashtu shpërblim në të njëjtën masë, për pjesëmarrjen në mbledhjet e Këshillit përfiton edhe përfaqësuesi i Presidentit të Republikës.
2. Fondet për shpenzimet e Këshillit të Prokurorisë përballohen nga buxheti i Prokurorisë së Përgjithshme.

Neni 19

Kohëzgjatja e mandatit

1. Prokurorët, anëtar të Këshillit të Prokurorisë, zgjidhen çdo tre vjet nga mbledhja e përgjithshme e prokurorëve.
2. Në rastet e kalimit të afatit tre vjeçar, mandati i anëtarit të Këshillit të Prokurorisë vazhdon deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj të këtij Këshilli.

Neni 20

Dispozita kalimtare

1. Rregullorja nr.1 datë 23.01.2006, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Prokurorisë” shfuqizohet.
2. Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Ina RAMA